



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-083

PER SHPËRBERJEN E TRUPAVE MBROJTËSE TË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) dhe nenit 154 të Kushtetutës së Republikës së Kosovë;

Miraton këtë

LIGJ PËR SHPËRBERJEN E TRUPAVE MBROJTËSE TË KOSOVËS

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Parimet e përgjithshme

1.1 Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), pasi i kanë përmbushur objektivat e tyre, përfshirë edhe mundësimin e rimëkëmbjes së Kosovës pas konfliktit, shpërbëhen brenda një viti nga përfundimi i periudhës së tranzicionit.

1.2 Programi i çmobilizimit dhe riintegritit do të përgatitet për pjesëtarët aktualë të TMK-së.

Neni 2

Aplikimi i ligjit

Ky ligj rregullon shpërbërjen e TMK-së dhe aplikohet për të gjithë pjesëtarët e TMK-së në kohën e miratimit të tij.

KREU II

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 3 Autoriteti mbi TMK-në

Deri në një shpërbërje të tillë, Prania Ndërkombëtare Ushtarake, në konsultim me Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil dhe Qeverinë e Kosovës ushtron autoritet ekzekutiv mbi TMK-në dhe vendos për programin kohor të shpërbërjes së saj. Kjo fillimisht kryhet përmes Zyrës së Koordinatorit të TMK-së (ZKTMK), e cila bashkëpunon me Prania Ndërkombëtare Ushtarake rreth çështjeve që i përkasin shpërbërjes së TMK-së.

Neni 4 Mandati i TMK-së

4.1 Duke iu nënshtruar programit kohor të shpërbërjes së përcaktuar nga neni 3 i këtij Ligji, mandati i TMK-së si organizatë për emergjencë civile vazhdon të përfshijë aktivitetet e përcaktuara në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/8 përfshirë:

- a) sigurimin e shërbimeve në raste të fatkeqësive natyrore;
- b) kërkimin dhe shpëtimin e të rrezikuarve;
- c) ofrimin e mundësive të veta për ndihma humanitare në zonat e izoluar;
- d) ndihmën për çminimin e zonave të minuara; dhe
- e) kontributin në rindërtimin e infrastrukturës dhe të komuniteteve.

4.2 Me qëllim të sigurimit të ofrimit pa ndërprerje i këtyre shërbimeve, përgjegjësia për to i transferohet Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në pajtim me programin e shpërbërjes së përcaktuar në nenin 3 të këtij Ligji. Këto detyra fillimisht parësore të FSK-së janë përgjigja ndaj krizave, asgjësimi i lëndëve plasëse dhe mbrojtja civile. Ruajtja e këtyre aftësive kyçe është thelbësore dhe do të jetë faktori qendror në përcaktimin e sekuencës së shpërbërjes së TMK-së dhe ngritjes së FSK-së.

Neni 5 Transferimi dhe tjetërsimi i pasurive të TMK-së

5.1 Prania Ndërkombëtare Ushtarake kryen auditimin e pasurive ekzistuese të TMK-së.

5.2 Prania Ndërkombëtare Ushtarake planifikon dhe mbikëqyr transferimin e pasurive të TMK-së tek FSK-ja.

5.3 Qeveria e Kosovës, me përkrahje adekuate nga PNU-ja, i tjetëron të gjitha pasuritë e TMK-së që nuk i nevojiten FSK-së.

KREU III

PERSONELI I TMK-SË

Neni 6

Mundësitë për personelin e TMK-së

6.1 TMK-ja si strukturë të çmobilizohet në pajtim me programin e shpërbërjes të përcaktuar në nenin 3 të këtij Ligji.

6.2 Aty ku duhet dhe në pajtim me nenin 7 të këtij Ligji, pjesëtarët e TMK-së mund të aplikojnë për të shërbyer në FSK.

6.3 Duke iu nënshtruar kërkesave të aplikueshme, pjesëtarët mund të kenë të drejtë për përfitimin e pensionit të TMK-së, paketës për shkurtim nga puna dhe/ose programit të riintegrit

6.4 Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, pjesëtarët e TMK-së të cilët japin dorëheqjen nga TMK-ja para çmobilizimit për të kërkuar punësim alternativ, ruajnë të drejtën e marrjes së këtyre përfitimeve ashtu si iu akordohen pjesëtarëve të tjerë të TMK-së që i përmbushin kriteret.

Neni 7

Procedura e aplikimit në FSK

Prania Ndërkombëtare Ushtarake dhe Qeveria e Kosovës përgatisin së bashku procedurën formale të përzgjedhjes për aplikuesit në FSK.

Neni 8

Pensionet

8.1 Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për dhënien e pensioneve për pjesëtarët e TMK-së që i përmbushin kriteret. Aranzhimet pensionale përcaktohen me ligj.

8.2 Pjesëtarët e “Skemës Pilote të Riintegritit” kanë të drejtën e marrjes së pensioneve në rastet kur i përmbushin kriteret sipas aranzhimeve të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

Neni 9

Paketa për shkurtim nga Puna

Individët që i përmbushin kriteret kanë të drejtë në paketën për shkurtrim nga puna, e cila mund të përfshijë pagesa për shkurtrim nga puna për personelin e çmobilizuar të TMK-së.

Neni 10

Programi i riintegrit

Programi i riintegrit përgatitet dhepërfshin dispozitën e këshillimit; identifikimin dhe kombinimin e aftësive me mundësitë e punësimit në dispozicion; dhe qasjen në mundësitë për trajnim, arsimim dhe zhvillim të biznesit të vogël.

KREU IV

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Neni 11

Kompetencat e Kuvendit të Kosovës

11.1 Kuvendi i Kosovës ka kompetencën e ushtrimit të mbikëqyrjes demokratike parlamentare mbi TMK-në deri në shpërbërjen e saj.

11.2 Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri mund t'i kërkojë Qeverisë të Kosovës dhe Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake që të informojnë rreth procesit të shpërbërjes së TMK-së.

11.3 Kuvendi i Kosovës ushtron funksionet e tij mbikëqyrëse pa paragjykuar mandatet e posaçme të organizatave ndërkombëtare të përcaktuara nga zgjidhja e statusit dhe Kushtetuta.

KREU V

DISPOZITAT PAS SHPËRBËRJES

Neni 12

Çështjet e trashëgimisë së TMK-së

12.1 Qeveria e Kosovës themelon një organ ndër-qeveritar për të koordinuar çështjet e trashëgimisë së TMK-së.

12.2 Derisa Qeveria e Kosovës të marrë përgjegjësi të plota mbi çështjet e trashëgimisë, Prania Ndërkombëtare Ushtarake dhe Zyra e Koordinatorit të TMK-së do të vazhdojnë të ndihmojnë në këtë aspekt.

Neni 13
Përkujtimi i TMK-së

13.1 Kontributi i TMK-së në rimëkëmbjen e Kosovës pas konfliktit dhe ofrimi i shërbimeve për emergjencë civile dhe ndihmë humanitare për të gjitha komunitetet në Kosovë, do të njihet zyrtarisht në mënyrën e përcaktuar nga Qeveria e Kosovës.

13.2 Ish-pjesëtarët e TMK-së kanë të drejtë t'i ruajnë uniformat e tyre dhe t'i veshin ato në raste solemne. Ata nuk kanë të drejtë të mbajnë armë, përveç nëse janë të autorizuar ndryshe.

Neni 14
Dispozitat përfundimtare

14.1 Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

14.2 Ky ligj mbizotëron ndaj çdo dispozite të legjislacionit ekzistues që nuk është në pajtim me të.

Ligji Nr. 03/L-083
13 qershor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI